

iSIGURIMET

Nr. #022 • Nëntor 2020 • www.bks-ks.org • Gazetë zyrtare e Byrosë Kosovare të Sigurimeve

RËNIE DRASTIKE
E SHITJES
SË POLICAVE

06

35 MILIONË EURO
DËME U PAGUAN VETËM
PËR NËNTË MUAJ

07

DËME MILIONËSHE
NGA COVID-19

Sami Mazreku, ushtrues i detyrës së drejtorit në Byronë Kosovare të Sigurimeve, në një intervistë për "iSIGURIME" ka thënë se pasojat nga COVID-19 janë shumë të mëdha për këtë institucion, pasi që shëtitja e policave deri në fund të muajit gusht të këtij vitit ka rënë për 63,1% në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Mazreku thotë se problem tjetër serioz është edhe rritja e vazhdueshme e automjeteve të pa siguruara. Sipas tij, është momenti i fundit kur të gjitha Institucionet duhet të punojnë së bashku për ta ulur këtë trend, e cila është njëra prej pengesave për anëtarësimin e Kosovës në Byronë e Kartonit të Gjellbër

04

63.1%

KA RËNË SHITJA E POLICAVE
KUFITARE GJATË PERIUDHËS
JANAR-GUSHT 2020 NË
RAPORT ME PERIUDHËN
JANAR-GUSHT 2019

Rënie drastike e shitjes së policave

Gjatë muajit korrik të vitit që lamë pas Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS) ka shitur 113,872 polica të sigurimit, derisa në muajin korrik të këtij viti BKS-ja ka shitur vetëm 28,622 polica. Në raport me muajin e njëjtë të vitit paraprak janë shitur 85,250 polica më pak.

ISIGURIME

Pandemia COVID-19 ka shkaktuar dëme të mëdha në vend, por edhe në të hyrat e Byrosë Kosovare të Sigurimeve, ku shuma e mjeteve të inkasuar nga shitja e policave kufitare deri më tash është shumë larg të hyrave të planifikuara për inkasim për këtë vit. Bazuar në të dhëna zyrtare të BKS-së shihet se në muajin mars të këtij viti Byroja kishte shitur 7,627 polica sigurimi, për dallim nga 17,170 sa ishin shitur në muajin mars 2019. Pra, të hyrat nga shitja e policave në mars të vitit 2020 ishin 261,202.32€, ndërsa 460,731.29€ ishin në mars të vitit 2019. Po ashtu, në prill 2020 janë shitur 2,020 polica, për dallim nga 34,230 sa ishin shitur në prill 2019. Në muajin prill 2020 të hyrat nga shitja e policave kanë qenë 117,375.22€, ndërsa 735,873.91€ ishin në prill të vitit 2019. Në muajin maj 2020 BKS-ja kishte shitur 3,923 polica, 19,399 ishin shitur në maj 2019. Nëse bëjmë krahasim në të hyra del se në maj 2020 të hyrat ishin 186,850.20€, për dallim nga 511,849.60€ sa ishin në maj 2019. Po ashtu edhe gjatë muajit qershor të këtij viti Byroja Kosovare e Sigurimeve ka shitur 21,394 polica, nga 25,798 sa ishin shitur në muajin e njëjtë të vitit paraprak. Në qershor 2020 të hyrat nga shitja policave kishin qenë 550,501.93€, ndërsa 628,008.32€ ishin në qershor të vitit 2019.

Bazuar në të dhëna zyrtare të Byrosë Kosovare të Sigurimeve shihet se rënie më e madhe e shitjes së policave është shënuar në muajin korrik të këtij viti, ku ishin shitur vetëm 28,622 polica nga 113,872 sa ishin shitur në korrik të vitit 2019. Pra, të hyrat nga shitja e policave në korrik 2020 ishin 687,889.53€, ndërsa 2,349,875.39€ ishin në muajin e njëjtë të vitit paraprak. Edhe në muajin gusht shuma totale e policave të shitura ishte 19,071, derisa shuma e të hyrave ishte 370,757.48€, e në muajin gusht 2019 shuma totale e policave të shitura ishte 73,006, e shuma e të hyrave 1,436,714.56€. Edhe në muajin shtator 2020 janë shitur vetëm 14,101 polica, nga 21,791 sa ishin shitur në muajin e njëjtë të vitit paraprak. Edhe shuma e të hyrave në shtator 2020 ishte më e vogël për 200 mijë euro nëse e krahasojmë me shtatorin e vitit 2019. “Deri më 26.10.2020, BKS-ja ka shitur 22,413 polica nga 23,601 sa ishin në tetorin e vitit 2019”, thuhet në të dhënat zyrtare të Byrosë Kosovare të Sigurimeve.

Numri i policave të shitura në periudhën 1 mars – 26 tetor 2020

	2019	2020	DALLIMI
MARS	17,170	7,627	-9,543
PRILL	34,230	2,020	- 32,210
MAJ	19,399	3,923	- 15,476
QERSHOR	25,798	21,394	- 4,404
KORRIK	113,872	28,622	- 85,250
GUSHT	73,006	19,071	- 53,935
SHTATOR	21,791	14,101	- 7,690
TETOR	23,601	22,413	- 1,188

TË HYRAT 1 MARS – 26 TETOR 2020

	2019	2020	DALLIMI
MARS	460,731.29€	261,202.32€	-199,528.97€
PRILL	735,873.91€	117,375.22€	-618,498.69€
MAJ	511,849.60€	186,850.20€	-324,999.40€
QERSHOR	628,008.32€	550,501.93€	- 77,506.39€
KORRIK	2,349,875.39€	687,889.53€	-1,661,985.86€
GUSHT	1,436,714.56€	370,757.48€	-1,065,957.08€
SHTATOR	520,581.12€	321,290.68€	- 199,290.44€
TETOR	560,682.25€	431,465.40€	- 129,216.85€

35 milionë euro dëme u paguan vetëm për nëntë muaj

Sipas të dhënave të fundit të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) shihet se vetëm gjatë nëntë muajve të parë të këtij viti kompanitë e sigurimeve, por edhe Byroja Kosovare e Sigurimeve kanë paguar dëme në vlerë prej 35 milionë euro. Krahëuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak shihet se pagesa e dëmeve është më e lartë për 0,64 %

ISIGURIME

Vetëm gjatë nëntë majave të parë të këtij viti, sipas të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), kompanitë e sigurimeve kanë paguar dëme hiç më pak se 35 milionë euro. Pagesa e dëmeve të paguara ndaj qytetareve edhe më tutje vazhdon të jetë e madhe, pavarësisht problemeve të mëdha me të cilat janë ballafaquar kompanitë e sigurimeve si pasojë e pandemisë COVID-19. Krahëuar me të dhënat e muajit gusht të vitit 2019, shihet se shuma e dëmeve të paguara thuhet është e njëjtë me demet e paguara gjatë muajit gusht të këtij viti.

DËMET E PAGUARA PËR ÇDO MUAJ

Në të dhënat zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës konstatohet se gjatë muajit shtator janë paguar rreth 4 milionë euro dëme, në muajin gusht janë paguar dëme në vlerë prej 3,8 milionë euro, ndërsa në korrik të këtij viti kompanitë e sigurimeve kanë paguar dëme në vlerë prej mbi 4,8 milionë euro. Duke i krahasuar me muajt paraprak të këtij viti, vlera e dëmeve dallon nga muaji në muaj, gjatë qershorit në emër të dëmeve kompanitë e sigurimeve kanë paguar 3,8 milionë euro, gjatë majit janë paguar 1,4 milionë euro, në prill janë paguar 3,1 milionë euro, në mars 3,1 milionë euro, në shkurt 4,1 milionë euro, si dhe në muajin janar shuma e dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimeve ishte 5,5 milionë euro, apo gati 100 % më e lartë sesa ishte në muajin e njëjtë në vitin paraprak.

DËMET E PAGUARA NGA VITI 2000 E DERI MË TASH

Sipas të dhënave zyrtare të BQK-së të cilat i ka siguruar 'ISIGURIME', nga viti 2000 e deri më tash kompanitë e sigurimeve kanë paguar hiç më pak se 500 milionë euro dëme. Duke u mbështetur në këto të dhëna shihet se gjatë 9 muajve të parë të këtij viti nga kompanitë e sigurimeve janë paguar mbi 35 milionë euro, gjatë vitit 2019 janë paguar 50 milionë euro, gjatë vitit 2018 janë paguar 42,7 milionë euro, gjatë vitit 2017 janë paguar 42,1 milionë euro, gjatë vitit 2016 janë paguar 36,5 milionë euro, gjatë vitit 2015 janë paguar 37 milionë euro, gjatë vitit 2014 janë paguar 31,1 milionë euro. Po ashtu, në vitin 2013 janë paguar 38,4 milionë euro, në vitin 2012 janë paguar 30,5 milionë euro, në vitin 2011 janë paguar 26,8 milionë euro, në vitin 2010 janë paguar 26,5 milionë euro, në vitin 2009 janë paguar 18,8 milionë euro, në vitin 2008 janë paguar 17,7 milionë euro, në vitin 2007 janë paguar 12,8 milionë euro, në vitin 2006 janë paguar 10,9 milionë euro, në vitin 2005 janë paguar 9,1 milionë euro, në vitin 2004 janë paguar 6,7 milionë euro, në vitin 2003 janë paguar 5,5 milionë euro, në vitin 2002 janë paguar 3,5 milionë euro si dhe në vitin 2000 janë paguar 2,6 milionë euro dëme.

VITI	PAGESA E DËMEVE	TË HYRAT TOTALE
2020 (1-9)	35,062,791 €	74.241,717 €
2019	49.977,495 €	97.999,080 €
2018	42.766,736 €	90.503,664 €
2017	42.151,078 €	84.919,344 €
2016	36.871,506 €	81.235,523 €
2015	36.971,397 €	78.767,663 €
2014	31.182,207 €	80.080,181 €
2013	38.448,821 €	77.385,883 €
2012	30.581,215 €	81.534,352 €
2011	26.812,984 €	78.095,611 €
2010	26.527,830 €	71.243,658 €
2009	18.834,757 €	67.756,310 €
2008	17.678,577 €	56.380,959 €
2007	12.821,635 €	50.811,083 €
2006	10.932,644 €	34.705,304 €
2005	9.165,533 €	47.212,598 €
2004	6.743,000 €	39.090,000 €
2003	5.583,705 €	37.060,000 €
2002	3.540,000 €	27.231,000 €
2001	/	/
2000	2.655,000	31.161,000 €

Dëme milionëshe nga COVID-19

Sami Mazreku, ushtrues i detyrës së drejtorit në Byronë Kosovare të Sigurimeve, në një intervistë për “iSIGURIME” ka thënë se pasojat nga COVID-19 janë shumë të mëdha për këtë institucion, pasi që shëtitja e policave deri në fund të muajit gusht të këtij vitit ka rënë për 63,1% në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Mazreku thotë se problem tjetër serioz është edhe rritja e vazhdueshme e automjeteve të pa siguruara. Sipas tij, është momenti i fundit kur të gjitha Institucionet duhet të punojnë së bashku për ta ulur këtë trend, e cila është njëra prej pengesave për anëtarësimin e Kosovës në Byronë e Kartanit të Gjellbër

iSIGURIME: Z.Mazreku, ka një muaj që ju jeni emëruar si ushtrues i detyrës së drejtorit në Byronë Kosovare të Sigurimeve, emërim i cili erdhi pas sukseseve tuaja të shumta në Shoqatën e Sigurimeve të Kosovës. Cili është plani juaj i ardhshëm në krye të këtij Institucioni të rëndësishëm ?

Mazreku: Ka më shumë 14 vite që unë punoj në sektorin e sigurimeve, respektivisht në Shoqatën e Sigurimeve të Kosovës. Në tri vitet e fundit kam qenë edhe në pozitën e drejtorit Ekzekutiv të Shoqatës. Ndonëse me një staf shumë simbolik, por me një energji të madhe, ne kemi punuar pa ndalur duke shënuar rezultate të shumta. Në vitet e fundit kanë ndodhur ndryshimet më të mëdha në sektorin e sigurimeve, sidomos gjatë dy dekadave të fundit dhe pa dyshim se një pjesë të kontributit për të arriturat e kemi dhënë edhe ne. Siç e dini edhe ju, më 1 tetor të këtij viti, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme unë jam emëruar ushtrues i detyrës së drejtorit të Byrosë Kosovare të Sigurimeve. Edhe këtu do të vazhdojmë me energjinë dhe dinamikën e madhe për të cilën jemi dëshmuar së paku në tri vitet e fundit. Pasi që është shumë kohë e shkurtër prej kur unë e kam marrë besimin e Asamblesë së Përgjithshme për ta drejtuar një Institucion të rëndësishëm siç është Byroja, ende nuk kam arritur ta kam një pasqyrë të saktë për gjendjen në këtë Institucion. Sido që të jetë, unë e kam hartuar një plan dinamik të punës i cili do të implementohet në ditët dhe në muajt në vijim. Duhet ta theksojmë se si në asnjë Institucion

113,232

POLICA TË SIGURIMIT KUFITAR JANË SHITUR GJATË PERIUdhës JANAR-GUSHT 2020

tjetër, COVID-19 e ka dëmtuar rëndë sektorin e sigurimeve, me këtë rast edhe Byronë Kosovare të Sigurimeve, ku sipas të dhënave që ne kemi shitja e policave është rënë shumë. Si pasojë e pandemisë COVID-19 për herë të parë tregu i sigurimeve në vendin tonë ka rënë dukshëm nga rritja e vazhdueshme që ka shënuar çdo vit. Bazuar në të dhëna zyrtare, tregu i sigurimeve si pasojë e pandemisë ka rënë prej më shumë se 30 %, derisa shitja e policave kufitare ka rënë në masën prej 63,1%. Pra, sipas të dhënave zyrtare, gjatë periudhës janar-gusht 2020 janë shitur 113,232 polica, nga 307,488 sa ishin shitur gjatë periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Shihet se kemi një rënie shumë të madhe e që ka reflektuar shumë në rënien e të hyrave, situatë e cila do të sjellë probleme të mëdha edhe në Byro. Në anën tjetër, gjatë periudhës në fjalë dëme kanë ndodhur mjaft, derisa të hyra ka shumë më pak në raport me vitin paraprak. Sido që të jetë edhe në këtë gjendje të rëndë financiare ne po mundohemi ta japim maksimumin duke trajtuar dhe paguar dëme në afate kohore të parapara me ligjet në fuqi.

iSIGURIME: Ju për disa vite keni qenë drejtor i Shoqatës së Sigurimeve, cilat janë prioritet tash si u.d i drejtorit të Byrosë Kosovare të Sigurimeve ?

Mazreku: Që nga dita e parë e punës në Byro ne kemi nisur me një dinamikë të madhe, megjithatë është ende herët të flitet për aktivitet e mëtutjeshme, pasi që koha prej kur e kam marrë besimin nga Asambleja e Përgjithshme është shumë e shkurtër. Pra, është vetëm një muaj. Nga gjithë ajo që kam parë deri më tash, shihet se Byroja Kosovare e Sigurimeve nuk është në gjendje të mirë financiare, kjo për arsye se shitja e policave ka rënë më masën prej 63,1%, pra bëhet fjalë për një rënie të madhe të shitjes nga reduktimi i lëvizjeve si pasojë e pandemisë COVID-19. Ne shpresojmë se në një të ardhme të shpejtë do të marrë fund pandemia, e nëse kjo vazhdon edhe më tutje gjendja në Byronë Kosovare të Sigurimeve do të përkeqësohet edhe më shumë.

iSIGURIME: Me vendim të Qeverisë së Kosovës deri në fund të këtij viti policat e sigurimit kufitar do të mbulohen nga Qeveria, apo zbatohet marrëveshja ?

Mazreku: Siç e tash edhe në pyetjen paraprake, përpos që të hyrat kanë rënë si pasojë e



“Nga gjithë ajo që kam parë deri më tash, shihet se Byroja Kosovare e Sigurimeve nuk është në gjendje të mirë financiare, kjo për arsye se shitja e policave ka rënë më masën prej 63,1%, pra bëhet fjalë për një rënie të madhe të shitjes nga reduktimi i lëvizjeve si pasojë e pandemisë COVID-19”, ka thënë **Sami Mazreku, ushtrues i detyrës së drejtorit në Byronë Kosovare të Sigurimeve.**

63.1%

KA RËNË SHITJA E POLICAVE KUFITARE GJATË PERIUdhËS JANAR-GUSHT 2020 NË RAPORT ME PERIUdhËN JANAR-GUSHT 2019

reduktimit të lëvizjes, të hyrat po ashtu kanë rënë edhe nga vendimi i Qeverisë për zbritje të policave prej 35 % dhe për mbulim të tyre deri në fund të këtij viti. Po ashtu, te pagesa e faturave nga ana e Qeverisë po ka vonesa të pagesës së mjeteve e që kjo drejtpërdrejt ndikon në punën e Byrosë. Ta zëmë kur bëhet pagesa, qeveria bazohet në numrin e automjeteve që ata i blejnë direkt në pika kufitare, por mos të harrojmë një numër i konsiderueshëm i qytetarëve përpos që blejnë policë në pikë kufitare, kur t'i skadojë ajo ata e vazhdojnë direkt në zyrat e Byrosë, e ku kjo mos përputhje e numrave të Ministrisë së Punëve të Brendshme në të dhënat tona reale po shkakton probleme dhe vonesa në pagesa të mjeteve. Kur dihet se Byroja ka obligime të mëdha si për pagat e

punëtorëve, ashtu edhe në pagesën e dëmeve, vonesa në pagesën e faturave sjell probleme të mëdha. Por ne shpresojmë se shumë shpejt do të gjejmë zgjidhje e që mos të ketë vonesa deri në fund të këtij viti, kohë kjo deri sa është në fuqi vendimi i Qeverisë së Kosovës për pagesën e policave kufitare për bashkatdhetarët tanë.

iSIGURIME: Ulja e çmimit të policave a ka reflektuar te të hyrat e BKS-së ?

Mazreku: Pa dyshim, ulja e çmimit prej 35 % është shumë e madhe dhe kjo do të reflektojë tej mase në punën tonë të përditshme. Por, ne shpresojmë që së shpejti të përfundojë pandemia dhe t'i kthehemi jetës normale, në të kundërtën me këtë trend problemet në të ardhmen do të jenë të mëdha.

iSIGURIME: Numri i automjeteve të pasiguruarua në vend, vazhdon të jetë i lartë. Keni ndonjë plan për ta ulur këtë ?

Mazreku: Gjatë gjithë vitit që po e lëmë pas, por edhe gjatë dy viteve të kaluara ne në vazhdimësi kemi ngritur shqetësimin tonë për rritjen e vazhdueshme të automjeteve të parregjistruara në vendin tonë. Në fund të muajit korrik ka nisur një iniciativë Institucionale për të punuar në këtë drejtim. Numri shumë i madh i automjeteve ta pa siguruarua, siç e kam thënë edhe shumë herë më parë, është shndër-

ruar në “kancer” të sektorit të sigurimeve. Aktualisht llogaritet se numri i automjeteve të parregjistruara është më shumë se 150 mijë dhe demet që shkaktojnë këto automjete janë shumë të mëdha, pra janë miliona euroshe vetëm brenda një viti. Në bazë të ligjit qytetarët që janë të dëmtuar nga këto automjeteve duhet të kompensohen nga Byroja Kosovare e Sigurimeve, e në anën tjetër rimbursimi i këtyre mjeteve nga qytetarët që e kanë shkaktuar dëmin është shumë i vështirë, pasi që lëndët nëpër gjykata vonohen tej mase.

iSIGURIME: Kur pritët që Kosova të jetë pjesë e Byrosë së Kartanit të Gjellbër ?

Mazreku: Pala kosovare, pra Industria e Sigurimeve, në vazhdimësi është angazhuar dhe po angazhohet për ta arritur këtë synim, por jo gjithçka është në dorën tonë. Krahas pengesave që i shkaktohen Kosovës nga aspekti ndërkombëtar, siç është mungesa e anëtarësimit në Kombet e Bashkuara Kosovë, ka edhe probleme tjera të brendshme për të cilat ne e kemi ngritur zërin disa here, por nuk ka pasur gatishmëri Institucionale për ta ulur numrin e automjeteve të parregjistruara në vend i cili është më i larti në rajon. Më këtë numër i cili llogaritet të jetë rreth 30 % e automjeteve që qarkullojnë nëpër rrugët e Kosovës një proces i tillë thuhet është i pamundur. Në fund të muajit korrik të këtij viti ne e kemi mirëpritur iniciativën e Qeverisë së Kosovës dhe Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) për trajtimin e automjeteve të parregjistruara në vendin tonë. Shpresojmë se angazhimi i përbashkët në një kohë sa më të shpejtë do të prodhojë rezultate dhe do t'i krijojë Kosovës mundësi më reale në anëtarësimin e Byrosë së kartanit të Gjellbër.

Numri i kontratave ra për 37.65%

Bazuar në të dhëna zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) shihet se gjatë periudhës janar-shtator 2020 numri i kontratave në sigurimin e jo jetës kishte arritur në 567,408, apo 37.65% më pak krahasuar me periudhën e njëjtë janar - shtator 2019

iSIGURIME

Hiç më pak se 37.65% ka rënë shitja e policave në sigurimin e Jo-Jetës gjatë periudhës janar-shtator 2020, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Bazuar në të dhëna zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) shihet se numri i kontratave në sigurimin e Jo-Jetës arriti në 567,408 duke shënuar një rënie në masën 37.65% më pak krahasuar me periudhën e njëjtë janar - shtator 2019.

Që nga konsolidimi i sektorit të sigurimeve, pra gjatë dy dekadave të fundit, kjo është hera e parë kur Industrisë e Sigurimeve shënon rënie aq të madhe të shitjes së policave si pasojë e pandemisë COVID-19.

“Volumi i primeve të shkruara bruto në vep-

rimtarinë e Jo-Jetës arriti shumën 71,583,109 euro, duke shënuar një rënie në masën prej 2.34% më pak krahasuar me periudhën janar - shtator 2019”, thuhet në raportin e fundit të Bankës Qendrore të Kosovës, raporton “iSIGURIME”.


POLICAT NË SIGURIMIN E JETËS U RRIJËN PËR 24,11%

Më tutje bazuar në të dhëna zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) shihet se gjatë periudhës janar-shtator 2020 numri i kontratave në sigurimin e Jetës arriti në 11,882, duke shënuar një rritje në masën 24.11% me shumë krahasuar me periudhën e njëjtë janar - shtator 2019. “Volumi i primeve të shkruara bruto në vep-

rimtarinë e Jetës arriti shumën 2,658,608 euro duke shënuar një rritje në masën prej 4.09% krahasuar me periudhën e njëjtë janar - shtator 2019”, thuhet në raportin e BQK-së

TREGU I SIGURIMEVE RA PËR 2.12%

Gjithnjë duke u bazuar në të dhëna zyrtare të BQK-së, shihet se gjatë periudhës janar - shtator 2020 tregu i sigurimeve ka pasur një rënie prej 2.12% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019. Volumi i primeve të shkruara bruto në krahësim me periudhën paraprake është zvogëluar me 1,608,091 euro më pak, duke arritur gjithsej shumën prej 74,241,717 euro. “Numri i kontratave arriti në 579,290 duke shënuar një rënie me 37.01% krahasuar me periudhën e njëjtë janar - shtator 2019”, thuhet në raportin e BQK-së.



567,408 polica të sigurimit të Jo Jetës janë shitur gjatë periudhës janar-shtator 2020.

37.65% ka rënë shitja e policave të sigurimit të Jo Jetës gjatë periudhës janar-shtator 2020, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

11,882 ka arritur numri i kontratave në sigurimin e Jetës gjatë periudhës janar-shtator 2020, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

4,09 % është rritur shitja e policave në sigurimin e jetës gjatë periudhës janar-shtator 2020, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.



Nënshkruhet Memorandumi i Mirëkuptimit me qëllim të zhvillimit të mëtejshëm të tregjeve financiare

Përmes këtij Memorandumi BQK-ja dhe AMF-ja vendosin një sistem bashkëpunimi reciprok dhe shkëmbim të informacioneve mes palëve, bazuar në rëndësinë e zhvillimit të tregjeve financiare të të dyja vendeve, i cili do të shtrihet në tregjet e sigurimeve / risigurimeve, tregjet e kapitalit, aktivitete të tjera financiare jobankare.

Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës Fehmi Mehmeti dhe drejtori i përgjithshëm ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Republikës së Shqipërisë, Ervin Mete, kanë nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit në funksion të rregullimit, licencimit dhe mbikëqyrjes së tregjeve. Përmes këtij Memorandumi BQK-ja dhe AMF-ja vendosin një sistem bashkëpunimi reciprok dhe shkëmbim të informacioneve në mes të palëve, bazuar në rëndësinë e zhvillimit të tregjeve financiare të të dyja vendeve, i cili do të shtrihet në tregjet e sigurimeve / risigurimeve, tregjet e kapitalit, aktivitete të tjera financiare jobankare. Guvernatori i BQK-së Fehmi Mehmeti e ka vlerësuar të rëndësishëm nënshkrimin e këtij Memorandumi. Ai u ndal tek rëndësia e bashkëpunimit reciprok mes dy rregullatorëve në adresimin e çështjeve me interes të përbashkët, në funksion të mbarëvajtjes dhe zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrje. Ndërsa, drejtori i AMF-së, Ervin Mete falënderoi Guvernatorin Mehmeti për angazhimin e tij në finalizimin e këtij memorandumi, duke theksuar se marrëveshja e re e bashkëpunimit i përgjigjet jo vetëm zhvillimeve të kohës, por edhe çështjeve që kanë dalë në pah ndër vite mes Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Në këtë Memorandum të Mirëkuptimit, parashihet vlefshmëria reciproke e policave të sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, detyrimet reciproke mbi praktikën e dëmeve, Memorandumi thellon linjat e bashkëpunimit mes dy rregullatorëve në funksion të mbikëqyrjes së integruar dhe efektive, në veçanti përmes kolegjeve mbikëqyrëse të grupeve të sigurimit, për shoqëritë vendase të sigurimit dhe risigurimit, të cilat kanë investime apo degë të tyre në vende të tjera. Gjithashtu, sa i përket tregut të sigurimeve palët angazhohen të adresojnë çështje të



veçanta të mbikëqyrjes në të dy vendet, si vlefshmërinë reciproke të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, detyrimet reciproke mbi praktikën e dëmeve apo trajtimin dhe pagesën e dëmeve. Në lidhje me tregjet e kapitalit, Shqipëria është në një stad më të avancuar për sa i përket kuadrit ligjor, nëpërmjet ligjeve të miratuara së fundmi, si edhe ka krijuar infrastrukturën e tregut, Bursën dhe Regjistrarin. Autoriteti është i gatshëm ta asistojë Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës në këtë drejtim. Gjithashtu, dy rregullatorët do të bashkëpunojnë në funksion të përmirësimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe digjitalizimit, duke iu përgjigjur evoluimit të vazhdueshëm të tregjeve nën mbikëqyrje, si dhe shkëmbimin e eksperiencave nëpërmjet takimeve të ndërsjella në funksion të rritjes së mëtejshme të standardeve në fushën e digjitalizimit dhe sigurisë kibernetike. Memorandumi

i Mirëkuptimit i nënshkruar nga të dyja palët, do të jetë në fuqi për një periudhë kohore të pakufizuar, derisa i njëjti shfuqizon Memorandumin e mëparshëm që ishte në fuqi nga viti 2008.

Në këtë Memorandum të Mirëkuptimit parashihet vlefshmëria reciproke e policave të sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, detyrimet reciproke mbi praktikën e dëmeve, Memorandumi thellon linjat e bashkëpunimit mes dy rregullatorëve në funksion të mbikëqyrjes së integruar dhe efektive, në veçanti përmes kolegjeve mbikëqyrëse të grupeve të sigurimit, për shoqëritë vendase të sigurimit dhe risigurimit, të cilat kanë investime apo degë të tyre në vende të tjera.

Takim me gazetarë

Ushtruesi i Detyrës së drejtorit të Byrosë Kosovare të Sigurimeve Sami Mazreku është takuar me gazetarë që përcjellin sektorin e ekonomisë në vend "Sot zhvillova një takim me gazetarë që përcjellin sektorin e Ekonomisë në vendin tonë. Ata i informova për problemet e mëdha që ka sjell COVID-19 edhe për Byronë Kosovare të Sigurimeve. Gjatë 8 muajorit të parë të vitit 2020, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak shitja e policave ka rënë në masë të madhe. Pra, kemi 200 mijë polica më pakë. Byroja Kosovare e Sigurimeve do të jetë Institucion i hapur për media për çfarëdo informa-



cioni të kërkojnë gazetarët" ka shkruar ai në faqen e tij në rrjetin social Facebook



Takim me drejtorin e thesarit

Ushtruesi i Detyrës së drejtorit të Byrosë Kosovare të Sigurimeve Sami Mazreku është takuar me drejtorin e thesarit Ahmet Ismaili, ku kanë diskutuar për rritjen e bashkëpunimit në mes këtyre dy Institucioneve.

Guvernatori takoi u.d drejtorin e Byrosë Kosovare të Sigurimeve

Guvernatori Mehmeti priti u.d së drejtorit të Byrosë Kosovare të Sigurimit

Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës Fehmi Mehmeti, ka pritur të martën u.d së drejtorin e Byrosë Kosovare të Sigurimit Sami Mazrekun.

Gjatë takimit guvernatori Mehmeti ka falënderuar Mazrekun për punën e deritanishme si drejtor i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës, derisa e ka uruar për detyrën dhe i ka ofruar përkrahje në ushtrimin e përgjegjësisë të reja. Në anën tjetër, Mazreku gjatë takimit të parë në cilësinë e u.d së drejtorit të Byrosë Kosovare të Sigurimit ka falënderuar guvernatorin Mehmeti për përkrahjen e vazhdueshme.

Mehmeti dhe Mazreku janë dakorduar për vazhdim të bashkëpunimit në mes të dy Institucioneve, Bankës Qendrore të Kosovës dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit.



Quantix: prezanton aplikacionet

Kompania Quantix L.L.C. sot në zyrat e Byrosë Kosovare të Sigurimit ka prezantuar aplikacionet për uljen e numrit të mjeteve motorike të paregjistruara e të pasiguruar.

Aplikacionet janë të ndërtuara në disa komponentë, që konsistojnë në funksionalizimin e:

1. Hartës së Aksidenteve, e cila mundëson identifikimin e zonave të caktuara me rrezikshmëri dhe frekuencë të lartë të aksidenteve,

2. Certifikatës së aksidentit, përmes së cilës qytetarët do të kenë mundësinë e verifikimit nëse një mjet motorik i caktuar ka pasur ose jo të shkaktuar aksident,



3. Sistemit anti-mashtrim, përmes të cilit do të analizohen rastet potenciale të mashtrimit në sigurime me qëllim të parandalimit të tyre,

4. Aplikacionit mobil për ndërgjegjësim të qytetarëve lidhur me sigurimet, të cilët do të marrin informacione të ndryshme mbi aksidentet dhe produktet e ndryshme të sigurimeve të cilat ofrohen nga industria e sigurimeve.

Këto aplikacione do të vihen në përdorim brenda një periudhe të shkurtër kohore, të cilat do të prezantohen për përdorim praktik dhe sa më të lehtë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.


Takim pune me koordinatore të Pikave Kufitare të Byrosë Kosovare të Sigurimeve



Prezantimi nga EKIN Patrol

Kompania e teknologjisë informative EKIN Patrol, përmes partnerit të saj ekskluziv teknologjik në Kosovë kompanisë “Info Soft Systems”, kanë prezantuar para u.d së Drejtorit Ekzekutiv të Byrosë Kosovare të Sigurimit Sami Mazreku dhe stafit të

institucionit, funksionimin dhe implementimin e projektit për identifikimin e veturave të paregjistruara/pasiguruar nëpërmjet EKIN pajisjeve për leximin automatik të targave të regjistrimit të mjeteve motorike dhe sistemin softverik për implementim.



Qalaj dhe Mazreku diskutojnë për thellim të bashkëpunimit

Ish drejtori i Përgjithshëm i PK-së, z. Rashit Qalaj me bashkëpunëtorë, është takuar me Sami Mazrekun, ushtrues i detyrës së drejtorit në Byronë Kosovare të Sigurimit. Qalaj dhe Mazreku diskutuan rreth fuqizimit të mëtejshëm të bashkëpunimit ndër-institucional me interes të sigurisë rrugore.

Takim me drejtorët e departamenteve të dëmeve



Sami Mazreku, ushtrues i detyrës së Drejtorit Ekzekutiv në Byronë Kosovare të Sigurimit, i ka takuar drejtorët e Departamenteve të Dëmeve të kompanive të sigurimit, anëtare të Byrosë Kosovare të Sigurimit. Në takim është diskutuar lidhur me ndryshimet e nevojshme për të avancuar sistemet e trajtimit të dëmeve dhe rritjen e efikasitetit në proceset e trajtimit të kompensimit të dëmeve materiale dhe jomateriale.